



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5 Prill 2023

Nr: 266

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS, PËR RAPORTIMIN E
VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
14 MAJ 2023

Sot më datë 5 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë;
Z. Leonard Daçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Bulqizë;
Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastër;
Zj. Amalia Millo, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dropull;
Zj. Denisa Durro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Përmet;
Zj. Vikrita Çuto, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë të Infstrukturës dhe Energjisë;
Z. Ermir Mema, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Memaliaj;
Z. Pashk Kafi person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kurbin;
Zj. Joda Ngucaj person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Selenicë;

Zj. Emirjona Pergjegjaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pukë;

Zj. Albiona Mehmeti person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shijak;

Z. Arben Skenderi, Drejtor i Përgjithshë pranë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

Zj. Keida Pula person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Konispol;

Z. Genci Floqi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Maliq;

Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër;

Z. Astrit Hado, Drejtor i Përgjithshë pranë Insitutit të Sigurimeve Shoqërore;

Z. Ceno Klosi, Drejtor i Përgjithshë pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve;

Zj, Rudina Llampa person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Skrapar;

Z. Reinis Çela person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lezhë;

Z. Flamur Mira, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Klos;

Zj. Klodiana Aliaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tropojë.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 31 (tridhjetë e një) veprimtarive publike, nga 20 (njëzetë) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Data: 05 Prill 2023

Nr: 266
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 31 (tridhjetë e një) indicie nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuara në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1- Bashkia Tiranë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 3 (tre) veprimtari publike, të **regjistruara me nr. 77, 78, 83** ID për të cilat pretendohet si vijon:
 - **Denoncimi nr. 77 ID**, *“Me familjarë të dëshmorëve dhe përfaqësues të organizatave të veteranëve të luftës, përkujuam 79-vjetorin e masakrës së 4 Shkurtit një datë, që ia kemi rikthyer kujtesës së qytetit me emërtimin “Dëshmorët e 4 Shkurtit” segmentin e rrugës nga Banka e Shqipërisë te ura e lumit të Lanës”.*
Prova link:
<https://www.facebook.com/bashkia.tirane.al/videos/750931183030325/>
 - **Denoncimi nr. 78 ID** *“Sot është një ditë e bukur për Vaqarrin, ku po përfundojmë shkollën e re “Bedri Llagami”, me kushte moderne për 600 nxënësit që mësojnë këtu.*
Prova link:

<https://www.facebook.com/bashkia.tirane.al/videos/713326633829628/>

- **Denoncimi nr. 83 ID** “Bashkia Tiranë ka postuar në faqen Facebook të institucionit zhvillimin e inspektimit të Kryetarit të bashkisë në godinat e Qytetit Studenti, me titullin: Në "Qytetin Studenti" po ndërtojmë tri godina të reja pritëse për studentët". Data e postimit është 4 shkurt 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar në këtë datë ose më herët. Ndërkohë nga konsultimi i ndërfaqes së raportimeve në KQZ, Bashkia Tiranë ka raportuar në datën 3 shkurt 2023 zhvillimin e aktivitetit me temë "Inspektim punimesh konviktesh", të cilin planifikonte ta zhvillonte në datën datën 8 shkurt 2023.

Prova link:

<https://fb.watch/jyOdXcFozw/>

Më datë 13.2.2023, dhe 16.2.2023, bashkisë Tiranë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk u janë përgjigjur kerkesave tona.

Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaritë e kryera nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Pjesëmarrja e punonjësve në inspektime, nuk e bën aktivitetin publik nga natyra, pasi kryetari i bashkisë në këtë rast është në përmbushje të detyrave të veta funksionale. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ.

- 2- **Bashkia Bulqizë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, të regjistruara me nr. 46 dhe 157 ID për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 46 ID “Në Ditën Ndërkombëtare të Arsimit, kryetari i bashkisë Bulqizë, z. Lefter Alla organizoi një takim me mësues e arsimdashës nga Bulqiza.”

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=546859094132779&set=pcb.546859490799406>

- Denoncimi nr. 157 ID “Banorët e lagjes #Minatori shprehën vlerësim për punën e bërë nga #BashkiaBulqizë gjatë këtyre katër viteve dhe premtuan mbështetjen e tyre të pakushtëzuar për planet tona në vijim dhe drejt fitores së radhës më 14 Maj 2023. #TëBashkuarJoTëNdarë#BulqizaJonë”

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=685951983326529&set=pcb.685952429993151>

Rezulton se aktiviteti i mësipërm është publikuar në 1 (një) media:

<https://bulqiza.info/2023/03/03/alla-takohet-me-banoret-e-laqjes-minatori-premtojne-mbeshtetje-te-pakushtezuar-per-planet-e-radhes/>”.

Më datë 9.2.2023, dhe 13.3.2023, bashkisë Bulqizë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por kjo e fundit nuk i është përgjigjur kerkesës.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 15.3.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur. Në seancën publike, përfaqësuesi i bashkisë deklaroi ndër të tjera se në momentin e zhvillimit të aktiviteteve, nuk kanë qenë të pajisur me kredencialet për aksesimin e ndërfaqes së raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit dhe mëqenëse veprimtaria nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

- 3- **Bashkia Gjirokastrë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 32 ID** për të cilat pretendohet si vijon: *"Me konkursin "Gjuha jonë sa e mirë..." mes shkollave 9-vjeçare nisëm sot siparin e një serie aktiviteteve që do të zhvillojmë në kuadër të 100 vjetorit të themelimit të Liceut të Gjirokastrës, shkolla që sot e mot e njohim si gjimnazi "Asim Zeneli" dhe që është një vatër emblematike e dijes dhe kulturës tonë".*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=883029043075371&set=pcb.883029443075331> ."

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet e-mail-it ka përcjellë shkresën nr. 1619 prot., datë 20.2.2023 ku ka sqaruar se: *"Konkursi "Gjuha jonë sa e mirë " mes shkollave 9-vjeçare është një aktivitet i organizuar nga Zyra Vendore Arsimore Gjirokastrë -Libohovë dhe bashkia Gjirokastrë ka qenë e ftuar në këtë aktivitet. Bëjmë me dije se aktiviteti në fjalë për të cilin kërkohet informacion është i realizuar më datë 20 Janar 2023. Nga ana e bashkisë Gjirokastrë ndërkohë është bërë disa herë kërkesë për tu pajisur me kredenciale për të aksesuar në ndërfaqen <https://aktivitetete.kqz.gov.al/> dhe ende jemi në situatën e pritjes nga ana juaj".*

Pasi jemi njohur me përgjigjen dhe informacionet e përcjella, më datë 27.2.2023, Zyres Vendore Arsimore Gjirokastrë-Libohovë i është kërkuar informacion dhe jemi informuar se: *"...aktiviteti "Gjuha Jonë sa e mirë" është një nismë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zhvillimin e një konkursi midis klasave të nënta në rang ZVA-je dhe duke vijuar më tej".*

Nga verifikimi i të dhënave, fakteve dhe rrethanave të marra në shqyrtim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vlerësohet se përgjegjësia për raportimin e këtij aktiviteti rëndon Zyrën Vendore Arsimore Gjirokastrë-Libohovë, si organizator i aktivitetit.

Pas verifikimit të të dhënave në sistemin e raportimit në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezulton se Zyra Vendore Arsimore Gjirokastrë-Libohovë nuk ka qenë e pajisur me kredencialet për raportimin e veprimtarive në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte, duke marrë parasysh karakterin dhe tematikën e veprimtarisë, vlerësojmë se

duhet të pushohet hetimi administrative dhe t'i tërhiqet vëmendja personit përgjegjës për raportim, të përmbushë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 92, të Kodit Zgjedhor.

4- Bashkia Dropull nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 141 ID** për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 141 ID** "*Bashkia Dropull së bashku me shkollat e Derviçianit dhe Bularatit organizuan sot në Kishën e Shën Mërisë në Peshkëpin e Sipërme aktivitetin tradicional kushtuar ditës "Hëna e Pastër". Punonjësit e bashkisë u shpërndanë fëmijëve gatime tradicionale si llagana, hallva, ëmbëlsira, si dhe disa balona. Me këtë rast, fëmijët u njohën me historinë dhe vlerat fetare të Kishës historike, ndërsa nuk munguan edhe lojërat e shumta. Kreshmë të mbarë!"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=920706092715278&set=pcb.920706922715195>

Më datë 06.03.2023, bashkisë Dropull, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë për informacion.

Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaria e kryer nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, e cila ka detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrative për bashkinë Dropull.

5- Bashkia Përmet, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 167 ID** për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 167 ID** "*Në kujtim të 9 marsit 1997, momentet historike dhe njerëzit e sakrifikuar do të kujtohen gjithmonë nga brezi në brez dhe emri i tyre do të gdhendet përjetësisht në historinë e kombit. Një prej tyre është edhe 9 Marsi i vitit 1997 një tragjedi e rëndë që u mori jetën 6 qytetarëve të pafajshëm përmetarë Tomor Mullaraj, Bledar Kasaj, Abaz Rama, Reshat Telhaj, Kristul Theodhori, Eftali Theodhori. Në këtë 26 vjetor të kujtimit të tyre pranë memorialit u zhvilluan homazheve dhe u vendosën kurora me lule nga miq, kolegë, familjarë dhe qytetarë përmetarë. I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre."*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=512551791066816&set=pcb.512551951066800>

Më datë 13.03.2023, bashkisë Përmet, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku janë dërguar të dhënat e aktivitetit të organizuar. Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar

se veprimtaria e kryer nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, e cila ka detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrative për bashkinë Përmet.

6- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka raportuar në ndërfaqe zhvillimin e një veprimtarie, e regjistruar me nr. **207 ID**, e cila rezulton të jetë zhvilluar para datës së raportuar dhe nuk ka raportuar një veprimtari, e regjistruar me nr. **75 ID**.

- Denoncimi nr. **207 ID** “ *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ më datën 11 mars 2023 zhvillimin e aktivitetit me temë “Inspektim i punimeve në Unazën e madhe të Tiranës” në datën 16 mars 2023.*

Ndërkohë nga konsultimi i faqes Facebook të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, vërehet se aktiviteti me këtë temë është postuar në datën 13 mars 2023. Gjithashtu aktiviteti është postuar edhe në faqen zyrtare të Zv. Kryeministres dhe Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Belinda Balluku në datën 13 mars 2023. Shkrimi që shoqëron postimin ka këtë përmbajtje:

“Në lotin 7 të Unazës së Madhe të Tiranës puna po ecën me ritme të kënaqshme, falë edhe bashkëpunimit me banorët, të cilët kanë mbështetur realizimin e këtij projekti. Në këtë zonë, projekti nuk parashikon vetëm ndërtimin e aksit për qarkullimin e automjeteve, por do të ketë edhe hapësira të dedikuara për qytetarët. Puna nuk do të ndalet deri në përfundimin e plotë të të gjithë veprës.”

Nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarit dhe institucionit përkatës, nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtij aktiviteti. Pra, rezulton se aktiviteti është kryer dhe data e deklaruar për zhvillimin e tij, në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së, ka qenë e plotësuar gabim. Ky aktivitet është transmetuar edhe nga media, në datën 13 mars 2023, konkretisht nga:

- TVKlan <https://tvklan.al/ministria-balluku-inspekton-punimet-ne-lotin-e-7-te-te-unazes-se-madhe/>;

- Agjencia Telegrafike Shqiptare <https://ata.gov.al/2023/03/13/balluku-unaza-e-madhe-e-tiranes-perfundon-brenda-2023-shit/> “

Më datë 23.3.2023, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike ku jemi informuar se:

“Lidhur me sa parashtrohet në denoncimin, ka pasur një gabim në raportimin e datës së inspektimit të Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë në kantierin e Unazës së Madhe të Tiranës, i cili ka ardhur si pasojë e një mosrakordimi të brendshëm të axhendës, por që nuk ka pasur asnjë synim në anashkalimin e detyrimeve ligjore “

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se veprimtaria e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është vlerësuar si veprimtari e lejuar për t'u zhvilluar.

Të ndodhur në kushtet që, veprimtaria e kryera nuk përbën veprimtari të ndaluara në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar në mbingarkimin e agjendës së Ministrit dhe ti tërhiqet vëmendja personit përgjegjës për raportim, për përmbushjen e detyrimit sipas kërkesave ligjore të përcaktuara.

- Denoncimi **nr. 75 ID** *"Me nënat shamibardha dhe gratë e palodhura të Ostrenit në një bashkëbisedim të hapur për nismat tona për zhvillimin e zonës, përmirësimin e jetës së banorëve dhe projektet e rëndësishme për të ardhmen."*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=559753282859343&set=pcb.559754046192600>

Më datë 13.2.2023, Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe jemi informuar *"Aktiviteti nuk është në funksionin e Znj. Belinda Balluku si Zv/Kryeministr apo Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë. Bëhet fjalë për një takim politik të organizuar nga Partia Socialiste e Bulqizës me gra dhe vajza të Ostrenit, ku zj. Balluku ka marrë pjesë si drejtuese politike e PS në Qarkun e Dibrës. Ky takim nuk është bërë mediatik."*

Referuar nenit 92 të Kodit Zgjedhor, pranë ndërfaqes së raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, raportohen vetëm veprimtaritë publike në përmbushje të detyrave funksionale të institucionit dhe që kanë karakter publik. Të ndodhur në kushtet që aktiviteti i mësipërm ka pasur karakter politik dhe nuk ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale të zj. Balluku, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ.

- 7- **Bashkia Memaliaj**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 162 ID**, dhe ka postuar në faqën zyrtare "Facebook" të institucionit 2 (dy) veprimtari politike, **të regjistruara me nr. 184, 185 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 162 ID** *"Mes mësuesve, nxënësve, klerikëve dhe përfaqësuesve të institucioneve vendore uruam festën e mësuesit. Jo pa qëllim u mblodhëm në Teqen e Koshtanit, për të nderuar e përkujtuar dhe kontributin e themeluesve të shkollës së parë shqipe në rrethin e Tepelenës. Në përfundim të aktivitetit, në shenjë mirënjohje mbollëm 10 pemë Oleandër dhuratë nga Bashkia Memaliaj. Gëzuar 7 Marsin gjithë mësuesve! Mirënjohje për misionin tuaj fisnik!"*

Prova link:

Data: 05 Prill 2023

Nr: 266
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike"

<https://www.facebook.com/photo?fbid=906648987250323&set=pcb.906649703916918>

Më datë 17.3.2023, bashkisë Memaliaj, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku jemi informuar se: *"...kjo veprimtari pati jehonë në "mjediset" sociale, nga ana e ZVAP Tepelenë-Memaliaj, nuk pati ndonjë veprim promocional, pasi gjithçka i dedikohet Shkollës Shqipe dhe autorët e vërtetë ishin nxënësit dhe mësuesit e shkollave që kaluan 1 (një) orë ndryshe në një Ditë Feste. ZVAT e përkrahu këtë event pa marrë autorësinë e organizimit, por nuk mori dot "frenat" e organizatorit ndaj nuk ftoi askënd zyrtarisht t'i bashkohej bashkëfestimit. Në profilin zyrtar të ZVA Tepelenë-Memaliaj, në rrjetin social Facebook, nuk do të gjeni asnjë postim që do të kompromentonte natyrshmërinë e këtij organizimi, apo do të binte ndesh me detyrimet që sjell "profili" ynë ligjor."*

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi e pa qartë se kush ka qenë organizatori i aktivitetit të mësipërm. Të ndodhur në kushtet që veprimtaria e mësipërme, për shkak të tematikës dhe natyrës së saj, nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar, të pushohet hetimi administrativ dhe t'i tërhiqet vëmendja të gjithë personave përgjegjës për raportim, të institucioneve të përfshira në këtë veprimtari, për përmbushjen e këtij detyrimi.

- Denoncimi nr. 184 ID *"Në faqen zyrtare të bashkisë Memaliaj është postuar një takim i strukturave të Partisë Socialiste me drejtuesen politike të qarkut znj. Mirela Kumbaro, ku është njoftuar edhe kandidatura e Partisë Socialiste për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Postimi mund të gjendet në linkun e mëposhtëm <https://www.facebook.com/bashkiamemaliaj1> dhe mban datën 12 Mars 2023. Përmbajtja e postimit: Këtë fundjavë në Memaliaj, bashkë me Mirela Kumbaro Furxhi dhe anëtarët e familjes socialiste, ku u rikonfirmua sërish për një mandat të dytë të vazhdimësisë në 14 Maj, kandidati ynë Gjolek Guci. Për herë të parë në historinë e bashkisë Memaliaj, qoftë kur ishte vetëm qytet po dhe tani që është Bashki më e madhe, skuadra që do ta drejtojë, do ta ketë mandatin e dytë, në vazhdimësi. Përvoja e këtyre viteve, mënyra objektive sesi ne shohim dhe analizojmë punën tonë deri tani e sesi do ta përmirësojmë edhe më tej, më japin bindjen e plotë se 4 vjeçari i ardhshëm do të jetë më i miri në bashkinë Memaliaj, qoftë përsa i përket infrastrukturës rrugore, ujësjellësave, rrjetit të energjisë elektrike, sistemimit dhe rregullimit të ambienteve urbane dhe qendrave të fshatrave, përkrahjes edhe më të madhe sociale ndaj shtresave në nevojë dhe qasje edhe më efikase e ndihmuese ndaj të gjithë bizneseve të cilëve zona jonë iu ofron mundësi. Ky lajm i shkëlqyer vjen në të njëjtën kohë kur Vjosa do të shpallet "Park Kombëtar" e viti 2023 do të jetë viti i Vjosës, kështu që për bashkinë Memaliaj e cila jetën e saj e zhvillon në brigjet e Vjosës, ky lajm i mirë bashkë me lajmin për të njëjtën skuadër në vazhdimësi, me energji të reja e të shtuara për qytetin, më bën të ndihem shumë optimiste për punët e mira që na presin! I uroj*

shumë suksese pjesëmarrësve në garë të cilët janë një vlerë e shtuar për skuadrën tonë dhe jam i bindur që bashku do të arrijmë rezultate të shkëlqyera.”

- Denoncimi **nr. 185 ID** “Në Faqen Zyrtare të Bashkisë Memaliaj është postuar një takim i strukturave të Partisë Socialiste me Drejtuesen Politike të Qarkut znj. Mirela Kumbaro ku është njoftuar edhe kandidatura e Partisë Socialiste për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Postimi mund të gjendet në linkun e mëposhtëm <https://www.facebook.com/bashkiamemaliaj1> dhe mban datën 11 mars 2023. Përmbajtja e postimit: Sërish e shtuna më gjen në qarkun e Gjirokastrës së bashku me Laertën, fillimisht në Memaliaj me kandidatin tonë Gjolek Guci më #14MAJ dhe anëtarët e familjes socialiste për të shkëmbyer ide, për të bashkëbiseduar hapur mbi bilancin e punëve të këtyre katër viteve dhe objektivat e mandatit të ardhshëm; Për të udhëtuar më pas drejt #Këlcyrës, ku do të vijojmë me Klement Ndonin, që shkon drejt një gare tjetër më 14 maj me gjithë mbështetjen tonë dhe të këlcyrriotëve në vijim të punëve të mira në qytetin që aq shumë ka ndryshuar dhe akoma më tej do të kthehet destinacion eko-turistik duke zhvilluar ekonominë e zonës.”

Më datë 21.3.2023 bashkisë Memaliaj i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet nr. 184 dhe 185 ID, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 21.3.2023 bashkia Memaliaj bën me dije se: “...konstatimi është i vërtetë lidhur me dy postimet që janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Memaliaj. Kjo është bërë në mënyrë të pa vetëdijshme nga ana e bashkisë, nisur dhe nga fakti që nuk kemi qenë të mirë informuar lidhur me përmbajtjet që duhen publikuar dhe cilat nuk duhen publikuar. Bazuar në konstatimin e drejtë dy postimet do të fshihen dhe në vijim do të tregohemi të kujdesshëm në atë çfarë publikohet, pasi bashkia Memaliaj është e predispozuar të respektojë ligjin dhe rregulloren e Kodit Zgjedhor.”

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, sqarohet se për shkak të paqartësisë në natyrën e veprimtarive, që lejohen të publikohen në rrjetet sociale të institucioneve, dhe për shkak se subjekti i denoncuar ka fshirë menjëherë postimet me përmbajtje politike, vlerësohet se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

8- Bashkia Kurbin, ka postuar 1 (një) veprimtari publike, e regjistruar me **nr. 181 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 181 ID** “Në faqen zyrtare të bashkisë Kurbin është postuar takimi i kryetares së bashkisë me strukturat e Partisë Socialiste lidhur me përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme, në Laç e Mamurras. Postimi gjendet në këtë link

Prova link:

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100063689200878> dhe mban datën 3 shkurt 2023.

Aktiviteti i publikuar "Bashkë me Benardin vijojmë takimet me organizatat socialiste në Laç e Mamurras. Organizim, komunikim me çdo qytetar, punë e fitore padyshim!

Denoncuesi pretendon se publikimi i bërë në faqen zyrtare të institucionit, bie në kundërshtim me nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Më datë 21.3.2023, bashkisë Kurbin i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 24.3.2023, është bërë me dije se *"Përsa i përket aktivitetit të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Kurbin, ju sqarojmë se një ndër personat që menaxhon faqen zyrtare të bashkisë Kurbin, menaxhon edhe faqe të tjera dhe kjo veprimtari politike është hedhur gabimisht nga ana e tij. Sapo është konstatuar nga ana e tij, ky postim është fshirë menjëherë."*

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, sqaroj se për shkak të paqartësisë në natyrën e veprimtarive, që lejohen të publikohen në rrjetet sociale të institucioneve, dhe për shkak se subjekti i denoncuar ka fshirë menjëherë postimet me përmbajtje politike, vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrative.

9- **Bashkia Selenicë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 179 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 179 ID** *"Nën kujdesin e vecantë të kryetarit të bashkisë Selenicë z.Pellumb Binaj dhe me pjesëmarrjen e të deleguarit politik z.Blendi Klosi, deputetit të zonës z.Vullnet Sinaj, Prefektit të Qarkut z. Flamur Mamaj, kryetarit të shoqatës "Labëria" z. Ahmet Demaj, përfaqësuseve të organizatave të dëshmorëve dhe veteranëve, nderuam sot në fshatin Bashaj, 7 luftëtarët trima të rënë në luftë me certifikatën "Dëshmor i atdheut"*.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=579754244190152&set=pcb.579754870856756>

Më datë 21.3.2023 bashkisë Selenicë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 24.3.2023, ka bërë me dije se *"..ky aktivitet është organizuar nga "Shoqata Atdhetare Kulturore Bashaj". Planifikimi i këtij aktiviteti është kryer nga ana e Prefekturës së Qarkut Vlorë në përputhje të vendimit nr. 851, datë 21.06.2021 të Ministrisë së Mbrojtjes, Komisionit Qendror të Statusit 'Dëshmor i Atdheut'. Kryetari i bashkisë Selenicë është gjendur i pranishëm në këtë aktivitet si rrjedhojë e një ftese të drejtuar personit të tij. Në përgjigje të këtij shqetësimi po ju nisim dhe ftesën drejtuar kryetarit të bashkisë Selenicë si dhe vendimin nr. 851 , 21.6.2021."*

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se referuar nenit 92, aktiviteti është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Të

Data: 05 Prill 2023

Nr: 266
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike"

ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Selenicë.

10- Bashkia Pukë, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, të regjistruara me nr. 158, 159 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 158 ID *“Ceremonia e dorëzimit të titullit Qytetar Nderi, akorduar nga këshilli bashkiak z. Nikoll Prendit (pas vdekjes)”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/100064645183888/videos/596467242016173/>

- Denoncimi nr. 159 ID *“Bashkia Pukë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe Zyren Arsimore Pukë, në kuadër të 7 Marsit, ditës së mësuesit, nderuan me Certifikata Mirënjohje mësuesit që këtë vit dolën në pension, duke lënë pas kontributin e tyre të nderuar ndër breza. Së bashku me kryebashkiakun Gjonaj që kishte përgatitur tufa lulesh për mësuesit ishte dhe drejtori i DRAP, z. Hasan Muça dhe drejtoresha e ZVA Pukë, znj. Blerinda Pemaj të cilët falenderuan mësuesit që këtë vit dolën në pension, për të gjithë mundin dhe sakrificën e tyre. Gëzuar 7 Marsin!*

Prova link:

<https://www.facebook.com/100064645183888/videos/1394794161370015>

Më datë 13.3.2023, bashkisë Pukë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 14.3.2023 jemi informuar se për denoncimin nr. 158 ID *“Ceremonia e dorëzimit të titullit “Qytetar Nderi”, akorduar nga këshilli bashkiak z. Nikoll Prendit (pas vdekjes), aktiviteti është organizuar dhe zhvilluar nga familjarët dhe kemi qenë në cilësinë e të ftuarit.*

Referuar denoncimin nr. 159 ID *“Bashkia Pukë nuk ka pasur kredenciale të saj të hapur për raportimet e aktivitete publike në faqen e KQZ, faqe e cila është hapur më vonë dhe është vënë në funksion duke vijuar më pas raportimet.”*

Përsa më sipër, referuar denoncimit nr. 158 ID, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se referuar nenit 92, aktiviteti është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Pukë.

Përsa i përket denoncimit nr. 159 ID, pas verifikimit të të dhënave në sistemin e raportimit në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se referuar datës së kryerjes së aktivitetit, institucioni nuk ka qenë i pajisur me kredencialet për raportimin e veprimtarive në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte, duke marrë parasysh karakterin

dhe tematikën e veprimtarisë, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ dhe ti tërhiqet vëmendje personit përgjegjës për raportim, të përmbushë këtë detyrim ligjor.

11- Bashkia Shijak, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 137 dhe 163 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 137 ID** *“Të rinjtë janë monitoruesit më të mirë të vendimmarrjeve tona sociale si pushtet vendor. Kam mirëpritur gjithmonë idetë dhe bashkëpunimin e tyre si përfaqësues të komuniteteve në adresimin e problematikave të ndryshme. Do të mbështesim të rinjtë me punësimin e tyre. Çdo student i diplomuar me rezultate të mira do t'i japim mundësinë për tu punësuar në Shijak, duke bashkëpunuar dhe me bizneset e zonës. Ne besojmë te zëri i të rinjve!”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=6056340214386664&set=pcb.6056340284386657>

Më datë 6.3.2023, bashkisë Shijak i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin nr. 137 ID, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 7.3.2023, jemi informuar se *“Ky aktivitet është mbajtur nga Këshilli Vendor Rinor më datë 25.02.202, ora 13:00, pa pjesëmarrje nga mediat.*

Këshilli Vendor Rinor (KVR) është miratuar me VKB nr. 34 datë 06.09.2022 dhe përfaqësues të tyre janë nxënës të gjimnazëve brenda territorit administrativ të bashkisë, sipas ligjit nr. 75/2019 "Për rininë" neni 10. Në zbatim të legjislacionit KVR rregullon marrëdhëniet e tij nëpërmjet manualit të përcaktuar nga Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve. Pra sa më sipër parashtruam kjo mbledhje nuk është mbledhur dhe drejtuar nga kryetari i Bashkisë z.Elton Arbana pasi ai ka qenë i ftuar nga të rinjtë të cilët organizuan eventin për të mbajtur një fjalim motivues për ta. Nisur nga udhëzimi juaj nuk është event i cili duhet të publikohet në web-in tuaj, pasi bashkia Shijak nuk është institucioni organizues.

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se referuar nenit 92, aktiviteti është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky detyrim rëndon mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Shijak.

- Denoncimi **nr. 163 ID** *“Gëzuar 8 Marsin! Gratë meritojnë më të mirën! Ato sakrifikojnë veten e tyre për familjen. Gratë kanë forcën për t'ja dalë mbanë çdo vështirësie. Bashkia do të vazhdojë të mbështesë çdo grua shijakase që ka nevojë për përkrahje. Ju uroj Gëzuar festën dhe gëzofshi çdo ditë në familjet tuaja!”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=6092186000802085&set=pcb.6092186474135371>

Më datë 13.3.2023, bashkisë Shijak i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 13.3.2023 ka bërë me dije se *“Ky aktivitet është mbajtur nga shoqëria civile më datë 21 shkurt, ora 10:00 me vullnet të lirë pa pjesëmarrje nga mediat. Aktivitet i kryer nga zonja me banim në Njësinë Administrative Maminas, të cilat kanë ndarë eksperiencat e tyre për arritjet vetjake profesionale dhe në shoqëri. Pra sa më sipër parashtruar, ky takim nuk është bërë dhe drejtuar nga kryetari i bashkisë z. Elton Arbana pasi ai ka qenë i ftuar për tu falenderuar për kontributin dhe mbështetjen që iu ka dhënë qytetarëve të Njësisë Administrative Maminas. Si e tillë nuk është event për publikim në webin tuaj pasi bashkia Shijak nuk është institucioni organizator. Bashkëlidhur edhe ftesa.”*

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se referuar nenit 92, aktiviteti është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky detyrim rëndon mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Shijak.

12- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 134 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 134 ID *“Trajnimi u zhvillua nën koordinimin e Negociatores se Kapitullit 22, zj. Romina Kuko dhe Sekretariatit Teknik me mbështetjen e Programit të Zhvillimit Rajonal të financuar nga Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim dhe Agjencia Austriake për Zhvillim”.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=569352891897744&set=pcb.569352938564406>

Më datë 6.3.2023, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 28.3.2023, u informuam se *“Siç jeni në dijeni, vendi jonë është i përfshirë në procesin e integritetit evropian për hapjen e kapitujve të negociatave. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është sekretariat teknik i grupit të punës për këtë kapitull dhe fokusi i punës së saj është vetëm në çështjet administrative. Aktiviteti i organizuar në kuadër të zhvillimit rajonal dhe politikave të kohezionit, nuk përmban materiale propagandistike, me thirrje elektorale, por është trajnim i anëtarëve të grupit të punës me qëllim avancimin e agjendës evropiane në përmbushjen e detyrimeve dhe masave që përmban kapitulli 22. Kësisoj, ky aktivitet publik nuk lidhet aspak me qëllimet politike apo thirrjet*

elektorale në favor të palëve. Ky trajnim është zhvilluar në datën 21 shkurt, me pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit të punës, të cilët janë punonjës të institucioneve qendrore sipas listës së institucioneve përgjegjëse e shprehur në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024, kapitulli 22. Anëtarët janë trajnuar nga ekspertja ndërkombëtare Maja Hranilovic, e kontraktuar nga projekti i financuar nga qeveria zviceriane Regional Development Programme Albania (RDPA). Temat e trajtuara janë politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë. Ky aktivitet nuk është mediatizuar, por është shpërndarë në faqen e Agjencisë në facebook në kuadër të programit të transparencës. Të tilla aktivitete janë të parashikuara në kalendarin e masave të grupit të punës si dhe bëhen pjesë e raporteve mujore, 3 mujore dhe vjetore pranë Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit si dhe institucioneve të BE në Bruksel.”

Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaritë e kryer nga subjekti i denoncuar nuk përbën veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Aktiviteti i kryer ka qenë i mbyllur për publikun dhe ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale të institucionit. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ.

13- Bashkia Konispol, ka postuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 186 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 186 ID “Në Faqen Zyrtare të Bashkisë Konispol është postuar një takim i takim i strukturave të Partisë Socialiste me Kryetarin e Bashkisë dhe Deputeten zj. Anila Denaj. Postimi mund të gjendet në linkun e mëposhtëm <https://www.facebook.com/profile.php?id=100063943080324> dhe mban datën 9 shkurt 2023 Përmbajtja e publikimit: Shkallë, Konispol Me Kryetarin e Bashkia Konispol - Shuaip Beqiri dhe strukturat e Partise Socialiste, zhvilluam një takim me banorët e kësaj zone. Diskutua mbi problematikat që ata kanë, ku çështjet e pronësisë, infrasktruktura rrugore dhe përmirësimi i furnizimit me energji elektrike mbeten problematika të mprehta për t’u adresuar. Forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve dhe përmirësimi i shërbimeve për banorët është me rëndësi për zhvillimin e kësaj zone.

Më datë 21.3.2023, bashkisë Konispol i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 25.3.2023, bashkia Konispol bën me dije se “Publikimi nuk është kryer në faqen zyrtare të bashkisë Konispol, por në adresën zyrtare, në rrjetin social "Facebook", nga administratori i faqes dhe në raste të vecanta edhe nga titullari i institucionit. Administratori i faqes, nuk gëzon trajnimin dhe njohuritë e posacme për të bërë interpretimin e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtaritë gjatë fushatës zgjedhore ... administratorit të faqes i është tërhequr vëmendja dhe i janë bërë me dije detyrimet që mbartim ne si institucion gjatë periudhës zgjedhore dhe po ashtu janë

marrë masa për fshirjen e këtij publikimi nga faqja e "Facebook" të Bashkisë Konispol".

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, sqaroj se për shkak të paqartësisë në natyrën e veprimtarive, që lejohen të publikohen në rrjetet sociale të institucioneve, dhe për shkak se subjekti i denoncuar ka fshirë menjëherë postimet me përmbajtje politike, vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

14- Bashkia Maliq, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 155, 161 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 155 ID** *"Starton bashkëpunimi i dytë midis Bashkisë Maliq dhe Korça Hub. Bashkia Maliq përmyll me sukses mbështetjen financiare për 60 të rinj pjesëmarrës në kurset teknologjike të programimit. Në fokus e ardhmja e Rinisë!"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=5859460467470396&set=pcb.5859470780802698>
".

- Denoncimi **nr. 161 ID** *"Në Podgorie - Lagjia Luadhalime për zgjidhjen e problematikave të banorëve"*.

Prova link

<https://www.facebook.com/photo?fbid=5872142846202158&set=pcb.5872152176201225>
".

Më datë 13.3.2023, bashkisë Maliq i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 15.3.2023, bën me dije se përse i përket aktivitetit objekt i denoncimit **nr. 155 ID** *"..sqarojmë se ky aktivitet ishte i planifikuar nga Qendra e Inovacionit dhe Teknologjise HUB Korçë dhe kryetari i bashkisë ka qenë në cilësinë e të ftuarit. Qendra e Inovacionit Korçë HUB, nuk na ka njoftur paraprakisht disa ditë me përpara për zhvillimin e tij. Njoftimi është bërë 1 ditë më përpara dhe ne e kemi patur të pamundur të raportojmë brenda afatit ligjor që parashikon neni 92, i Kodit Zgjedhor, 5 (pesë) ditë para zhvillimit të veprimtarisë. (bashkëlidhur ftesa).*

Përse i përket aktivitetit objekt i denoncimit **nr. 161 ID** *"sqarojmë se kjo veprimtari ka qenë e menjëhershme pasi kryetari i bashkisë është thirrur nga vetë banorët në lidhje me një problematikë të rëndë në rrjetin e energjisë elektrike, e cila kishte sjellë probleme shqetësuese për banorët. Kryetari ka vajtur në terren për t'u njohur me problematikën dhe për të ofruar ndihmën institucionale."*

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se për denoncimit me nr. 155 ID, vlerësoj se referuar nenit 92, aktiviteti është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky detyrim rëndon mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Maliq.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se për denoncimit me nr. 161 ID, veprimtaria publike e kryer ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale të kryetarit të bashkisë dhe vlerësohet se, në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, nuk përbën veprimtari të ndaluar. Afati 5 ditor i parashikuar nga ligji, duhet të zbatohet në të gjitha rastet e veprimtarive publike të institucionit, ndërsa për rastet e emergjencës, që dalin jashtë parashikimit organit publik, vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata dhe të pushohet hetimi administrativ për bashkinë Maliq.

15- Bashkia Shkodër, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, të regjistruara me nr. **143, 146 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **143 ID** “Kryetari i Bashkisë Shkodër z. Bardh Spahia priti në një takim të rinjtë e Këshillit Studentor të Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi”.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=580569920756451&set=pcb.580570507423059>

- Denoncimi nr. **146 ID** “Pata kënaqësinë që për shkollat pjesëmarrëse të dorëzoja certifikatat e përmbylljes së projektit. Ky vizion dhe idetë e prezantuara nga të rinjtë e gjimnazeve janë një shembull i mirë se si mund të zhvillojmë qytetin tonë”.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=581758327304277&set=pcb.581759157304194>

Më datë 6.3.2023, bashkisë Shkodër i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 7.3.2023, bën me dije se përsa i përket aktivitetit objekt i denoncimit nr. **143 ID** “... Aktiviteti është organizuar me iniciativë të vetë Këshillit Studentor, me datë 28 shkurt 2023, ora 13:30. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë studentë të Universitetit, anëtarë të Këshillit Studentor.

Përsa i përket aktivitetit objekt i denoncimit nr. **146 ID** “Aktiviteti me temë: Levizje rinore - Qyteti im Ekologjik është organizuar nga Universiteti Polis në bashkëpunim me “Forumin Shqiptar Liqeni i Shkodrës”, në kuadër të projektit #GreenAL, me datë 28 shkurt 2023, ora 10:00, me pjesëmarrjen e Universitetit Polis, shoqatës “Forumi Shqiptar i Liqenit të Shkodrës” dhe 3 gjimnaze të Shkodrës 28 Nëntori, Jordan Misja dhe Oso Kuka.

Në të dyja rastet bashkia Shkodër është, pjesëmarrëse në aktivitet dhe jo organizator i këtyre aktiviteteve. Prandaj gjykoam se ato nuk janë objekt i respektimit të afateve të përcaktuara në nenin 92, pika 2”.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se bashkia Shkodër nuk është organizatore e aktivitetit të sipër përmendur, për pasojë në referim të legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportimin e aktivitetit nuk rëndon mbi këtë institucion. Ky detyrim rëndon mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Shkodër.

16- Instituti i Sigurimeve Shoqërore/Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari, **të regjistruar me nr. 133 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 133 ID** *“Drejtori i Përgjithshëm i ISSH Astrit Hado dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve Ceno Klosi, së bashku me grupet e punës zhvilluan një takim për shkëmbimin e ndërsjelltë të informacioneve”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=497608152565960&set=pcb.497608232565952>”.

Më datë 6.3.2023, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 7.3.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bën me dije se *“Takimi të cilit KQZ i referohet sipas linkut të dërguar (marrë nga Facebook i DPT) nuk është një veprimtari publike në kuptim të nenit 2, pika b, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, por është një takim pune i zhvilluar midis dy titullarëve të dy institucioneve, për zbatimin e një akti nënligjor të hyrë në fuqi, zbatimi i të cilit prek dy institucionet”*. Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për informacion.

Përsa më sipër, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaritë e kryer nga subjekti i denoncuar nuk përbën veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Aktiviteti i kryer ka qenë i mbyllur për publikun dhe ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale të institucioneve. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ.

17- Bashkia Skrapar, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 160, 164 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 160 ID** *“7 Marsi - Festa e mesuesit Përmes emocioneve të veçanta mesuesit në pension festuan së bashku ditën e mesuesit. Një takim i organizuar me iniciativën e kryetarit të Bashkisë, z. Adriatik Mema, mbledhi së bashku më shumë se 60 mesuese dhe mesues të cilët janë tashmë në pension. Të gjithë sollën në këtë takim copëza nga jeta e tyre profesionale e shumë viteve më parë. “Vlerësimi, respekti dhe mirënjohja për figurën e mesuesit”, duhet të*

jetë një konstante e përhershme e shoqërisë, tha ndër të tjera në fjalën e tij kryetari i Bashkisë. Pavarsisht se ishte hera e parë që organizohej një takim i kësaj natyre, vëmendja e dretjuesve të Bashkisë ndaj mësuesve nuk ka munguar asnjëherë. Ndonëse në mungesë, pjesë e nderimeve në këtë ditë të veçantë ishin edhe shumë mësues nga Tirana, Gjirokastra, Himara, Vlora, Korça, Elbasani, Berati, etj, që kanë shërbyer me aq profesionalizëm dhe përkushtim qytetar në Skrapar shumë e shumë vite më parë. Me kontributin që ata kanë dhënë, do të jenë përherë të nderuar në çdo takim apo event që lidhet me arsimin në Skrapar. Gëzuar 7 Marsin, mësuese dhe mësues të Skraparit! Të nderuar dhe respektuar qofshi gjithmonë."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=216506804225503&set=pcb.216510774225106>

- Denoncimi nr. **164 ID** "Festa e nënës në bashkinë Skrapar, festa e 8 Marsit të këtij viti mbledhi bashkë një grup të veçantë grash dhe nënash. Nëna të cilat kanë fëmijë me aftësi ndryshe, apo gra bashkëshortët e të cilave janë ndarë nga jeta, ishin sot në ambientet e bashkisë Skrapar për t'i uruar njëra tjetrës festën e 8 Marsit. Kryetari i bashkisë, z. Adriatik Mema, kishte organizuar me këtë rast një ceremoni modeste. Duke ju uruar atyre 8 Marsin, z. Mema, ndër të tjera, u shpreh: "Më shumë se sa ajo çka është e veçantë për secilën prej jush, ajo që ju bashkon dhe më ka shtyrë mua të organizoj këtë takim, është karakteri, përkushtimi dhe sakrificat e jashtëzakonshme që ju bëni, për të përballuar sfidat që ju ka ofruar jeta. Ju jeni vërtet një shembull kuptimplotë se çfarë është në gjendje të bëjë një grua, apo një nënë për fëmijët dhe familjen e saj". Ky i sotmi, ishte një takim shumë prekës dhe u përcoll me shumë emocione nga të gjitha zonjat pjesëmarrëse. Në fund të ceremonisë, kryetari i Bashkisë shpërndau dhurata simbolike për të gjitha gratë e pranishme. Gëzuar 8 Marsin nëna dhe motra! Qofshi përherë të lumtura!"

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=216949457514571&set=pcb.216949704181213>

Më datë 13.3.2023, bashkisë Skrapar i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur kërkesës.

Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaritë e kryera nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Kryetari i bashkisë në këtë rast, është në përmbushje të detyrave të veta funksionale. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ.

18- Bashkia Lezhë, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 154 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 154 ID “Në Raboshtë fryn erë tjetër nga herët e tjera! Një takim me shumë mirësi dhe diskutime! Koha për të vlerësuar punën dhe besuar tek zhvillimi larg eksperimenteve të demshme që nuk të çojnë askund!

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1884675165201324&set=pcb.1884675645201276>

Më datë 13.3.2023, bashkisë Lezhë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur kërkesës.

Referuar nenit 92 të Kodit Zgjedhor, pranë ndërfaqes së raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, raportohen vetëm veprimtaritë publike në përmbushje të detyrave funksionale të institucionit dhe që kanë karakter publik. Vlerësojmë se aktiviteti i mësipërm ka pasur karakter politik, i kryer jashtë ambienteve të institucionit, dhe nuk ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale të z. Ndreu. Në këto kushte, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Lezhë.

- 19- Bashkia Klos**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 145 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

Denoncimi nr. 145 ID “Jemi çdo ditë në terren për t’ju shërbyer të gjithë banorëve në çdo Njësi Administrativ. Në Njësinë Administrative Suç, ka nisur puna për rehabilitimin e rrugës së fshatit Kujtim Qytetarët gjithmonë të parët!

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=219783113909361&set=pcb.21978330724267> ”

Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaria e kryer nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Kryetari i bashkisë në këtë rast është në përmbushje të detyrave të veta funksionale. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ.

- 20- Bashkia Tropojë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 178 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 178 ID “Së bashku me Kujtimin ndoqëm sot nga afër ecurinë e punimeve në rrugën e #Sylbicës si dhe ndërtimin e urave “Bejli”.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=649786670488206&set=pcb.649786723821534>

Më datë 13.3.2023, dhe datë 21.3.2023 bashkisë Tropojë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur kërkesës.

Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se

veprimtaria e kryera nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Pjesëmarrja e punonjësve në inspektime, nuk e bën aktivitetin publik nga natyra, pasi kryetari i bashkisë në këtë rast është në përmbushje të detyrave të veta funksionale. Përsa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për:
 - a) Z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë;
 - b) Z. Leonard Daçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Bulqizë;
 - c) Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë;
 - d) Zj. Amalia Millo, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dropull;
 - e) Zj. Denisa Durro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Përmet;
 - f) Zj. Vikrita Çuto, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë të Infstrukturës dhe Energjisë;
 - g) Z. Ermir Mema, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Memaliaj;
 - h) Z. Pashk Kafi person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kurbin;
 - i) Zj. Joda Ngucaj person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Selenicë;
 - j) Zj. Emirjona Pergjegjaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pukë;
 - k) Zj. Albiona Mehmeti person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shijak;
 - l) Z. Arben Skenderi, Drejtor i Përgjithshëm pranë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

- m) Zj. Keida Pula person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Konispol;
 - n) Z. Genci Floqi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Maliq;
 - o) Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër;
 - p) Z. Astrit Hado, Drejtor i Përgjithshëm pranë Insitutit të Sigurimeve Shoqërore;
 - q) Z. Ceno Klosi, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve;
 - r) Zj, Rudina Lampa person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Skrapar;
 - s) Z. Reinis Çela person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lezhë;
 - t) Z. Flamur Mira, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Klos;
 - u) Zj. Klodiana Aliaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tropojë.
2. Tërheqje vëmendje për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
 3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI